



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 269, Datë 27.10.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 68, DATË 08.04.2025
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “RENEW” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2532/3 prot., datë 24.10.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “RENEW” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “RENEW” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 68, datë 08.04.2025, ka licencuar shoqërinë “RENEW” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.
- Në kuptim të sa përcaktuar në pikat 2, 3, 4 dhe 5 shoqëria duhet të raportojë në ERE në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda datës 31.08.2025; të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.09.2025; si dhe jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe përditësimin e informacionit mbi strukturën organizative. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve 2, 3 dhe 4.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “RENEW” sh.p.k., me shkresën e datës 20.06.2025, protokolluar në ERE me nr. 1920 prot., datë 23.06.2025, ka njoftuar fillimin e punimeve të “Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprat ndihmëse” nga data 04.07.2025.
- Me shkresën e datës 08.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2532/2 prot., datë 08.10.2025, shoqëria ka depozituar procesverbalin e datës 04.07.2025, nënshkruar midis shoqërisë zhvilluese “RENEW ENERGY” sh.p.k., subjektit ndërtues “KIRAC GREEN ENERGY” sh.p.k., dhe Mbikëqyrësit të punimeve “ABKONS” sh.p.k., si dhe kopjen e lejes së ndërtimit të zbardhur nr. 1100/7 prot., datë 12.06.2025, me afat 12-muajsh.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Referuar dokumentacionit të paraqitur (njoftimi i datës 23.06.2025 dhe procesverbali i datës 04.07.2025), rezulton se kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 68, datë 08.04.2025 (raportimi i fillimit të punimeve brenda datës 31.08.2025) është përmbushur dhe për rrjedhojë, vlerësohet të shfuqizohet.
- Leja e ndërtimit nr. 1100/7, datë 12.06.2025, ka afat 12-muajsh që përfundon më 11.06.2026; po ashtu, në nenin 9, pika 2 të kontratës me MIE nr. 2426 rep., nr. 1571 kol., datë 28.04.2023, parashikohet vënia në punë brenda 12 muajve nga marrja e lejeve për fillimin e punimeve. Në këto kushte, afati për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit vlerësohet të përshtatet me afatin maksimal të lejes së ndërtimit.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “RENEW” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës.
- Për sa më sipër, vlerësohet të ndryshojë kushti i përcaktuar në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, duke ju referuar tashmë afatit kohor të lejes së ndërtimit si afati maksimal për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “RENEW” sh.p.k., afat i cili llogaritet të jetë data 11.06.2026.
- Gjithashtu, me plotësimin e kushtit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, dhe pika 5 e vendimit duhet të reflektojë këtë ndryshim dhe të përcaktojë se *ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të mbetura të këtij vendimi, konkretisht ato të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të tij.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, shfuqizohet.
2. Pika 3 e vendimit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, ndryshon dhe bëhet: *“Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 11.06.2026”.*
3. Pika 5 e vendimit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, ndryshon dhe bëhet: *“Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi.”.*
4. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “RENEW” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., FTL sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI